



Teksti zyrtar siç është amendamentuar me 11.11.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në bazë të nenit 64 pika (a) dhe (b) dhe nenit 128.1 dhe të Kreut VI të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenit 29.1, 20 dhe të Kreut VI të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nxjerr:

RREGULLËN ZGJEDHORE Nr.12/2009
KUFIZIMI I SHPENZIMEVE TË FUSHATËS DHE DEKLARIMI FINANCIAR

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1.1 Për qëllimet e kësaj Rregulle shprehjet vijuese, “shpenzim”, “shpenzim për fushatë”, dhe nënkuptojnë përkufizimet gjegjëse që përcaktohen në nenin 3 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

1.2 “Kufizim i shpenzimeve të fushatës” nënkupton shumën maksimale të parave që mund të shpenzohen nga një subjekt politik i certifikuar si shpenzime të fushatës për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, Zgjedhjet për Kuvendet Komunale dhe për Kryetarë të Komunave.

1.3 “Auditor për Fushatë” nënkuptohet organizata e cila është e ngarkuar nga Zyra me detyrë specifike të auditojë shpenzimet e fushatës siç është përshkruar në nenin 41.1 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe kontributet

2.1 Kufizimi i shpenzimeve të fushatës për të dy palë zgjedhjet, për Kuvendet Komunale dhe për Kryetarë të Komunave në një komunë do të jetë pesëqind euro (500 €) për çdo një mijë (1000) votues të regjistruar në atë komunë. Kufizimi i shpenzimeve të fushatës për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës do të jetë pesëqind euro (500 €) për çdo një mijë (1000) votues të regjistruar.

KQZ-ja përcakton maksimumin e shpenzimeve të fushatës mbështetur në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve në kohën e freskimit të fundit të listës së votuesve në dispozicion të KQZ-së

2.2 Kufizimi i shpenzimeve të fushatës siç përcaktohet në nenin 2.1 përmbledhet për të gjitha zgjedhjet në të cilat konkurren subjekti politik

2.4 Shpenzimet maksimale për fushatë zbatohen për çdo mall dhe shërbim të shpenzuar për qëllime të fushatës pa marrë parasysh kohën e blerjes apo të pajisjes me shërbime.

Neni 3

Kërkesat për Deklarim Financiar

3.1 Çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje duhet t'i dorëzojë Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke e përdorur formatin që është bashkangjitur si Shtojca 1 dhe duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit

Financiar për Fushatën i dorëzohet Zyrës për Regjistrim të Partive Politike jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.

3.2 Të gjithë kandidatët e Subjekteve politike që kualifikohen për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave duhet të ja dorëzojnë raportin e kompletuar financiar të fushatës në pajtushmeri me rregullen zgjedhore nr. 10/2009 në Raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar Komune

3.3 Raport i Publikimit Financiar të Fushatës, i secilit subjekt politik, duke i përfshirë të gjitha degët e tyre dhe pjesët përbërëse, përfshinë publikimin komplet dhe të saktë të:

- a) të ardhurave të subjektit politik për periudhën raportuese, përfshirë burimin dhe datën e të gjitha kontributeve me para të gatshme;
 - b) të gjitha shpenzimet, përfshirë shpenzimet e fushatës, të bëra nga subjekti politik gjatë periudhës raportuese; dhe
 - c) një fletë bilanci që i paraqet pasuritë, detyrimet dhe barazimin e subjektit politik prej ditës së parë deri te dita e fundit e periudhës së raportimit.
- e) Subjekti politik i certifikuar duhet të sigurojë që secila nga degët e tij ose pjesët e tij përbërëse të plotësojnë raportin financiar informues duke shfrytëzuar formularin e bashkëngjitur si Shtojca 2.

3.4 Çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje i mban dhe ruan në arkivat e tyre, për një periudhë shtatë (7) vjeçare, shënimet e sakta dhe të detajuara të gjendjes financiare të subjektit dhe të gjitha degëve për periudhën e mbuluar me Raportet e Publikimit Financiar të Fushatës, përfshirë:

- a) librat e mbajtjes së llogarive me shënime, në pajtueshmëri me parimet llogaritëse të pranuar në përgjithësi;
 - i. të gjitha të ardhurat sipas burimit, shumës, duke e identifikuar mënyrën se si është kryer pagesa (dmth para të gatshme, çek, draft bankar, etj); dhe
 - ii. të gjitha pagesat të cilat i ka kryer subjekti politik ndaj personit tjetër, qëllimi i pagesës dhe mënyra se si është kryer pagesa;
- b) dëftesat për të gjitha shpenzimet që tejkalojnë shumën prej njëqind euro (100 €);
- c) shënimet bankiere për të gjitha llogaritë të cilat i mban subjekti politik ose që janë në emër të tij;
- d) dokumentet të cilat e ndërtojnë bazën ligjore për pronësi ose posedim të tërë pasurisë së patundshme të subjektit politik;
- e) kontratat, partner i të cilave është subjekti politik, përfshirë kontratat lidhur me qiranë ose blerjen e pasurisë së tundshme apo të patundshme;
- f) një regjistrim i të gjitha kontributeve të subjektit, pa marrë parasysh se kur janë bërë, përfshirë:
 - i. vlerën e secilit kontribut;
 - ii. datën kur secili kontribut është dhënë;
 - iii. emrin e plotë, adresën dhe numrin e leternjoftimit, ose te nje dokumenti tjetër identifikimi; dhe
 - iv. emrin e plotë të personit i cili e ka pranuar kontributin në emër të subjektit.

3.5 Të gjithë zyrtarët për financa ndjekin një trajnim për llogaritjen dhe auditimin, të organizuar nga Zyra menjëherë pas emërimit të tyre, nëse ata nuk i ofrojnë Zyrës një shkallë të pranueshme të ekspertizës dhe përvojës që tregon se një trajnim i tillë nuk është i domosdoshëm.

Neni 4 Auditimi

4.1 Zyra auditon të gjitha Raportet e publikimit Financiar të Fushatës apo Formular të Publikimit Financiar të Kandidatit. Shfrytëzimi i një auditori të jashtëm, si auditor fushate, është çështje e vendimit të KQZ-së.

4.2 Të gjitha subjektet politike bashkëpunojnë plotësisht me Auditorin e Fushatës dhe i ofrojnë auditorëve qasje të plotë e pa pengesa në regjistrat financiar të subjektit politik, përfshirë pa kufizim të gjithë regjistrat të cilët i referohen nenit 3.5 të kësaj rregulle.

4.3 Auditori i Fushatës ia paraqet rezultatet paraprake të auditimit, përfshirë listën e të gjitha gabimeve ose lëshimeve të dukshme, organit më të lartë ekzekutiv të subjektit politik brenda dyzetepesë (45) ditëve prej fillimi të auditimit dhe jo më vonë se katër (4) muaj pas zgjedhjeve.

4.4 Subjekti politik mundet, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës prej ditës kur i ka pranuar rezultatet paraprake, të paraqes raport të korrigjuar financiar dhe një sqarim që i adreson gabimet ose lëshimet e mundshme të identifikuar nga Auditori i fushatës.

4.5 Auditori i Fushatës ia dorëzon raportin përfundimtar të auditimit KQZ-së dhe organit më të lartë ekzekutiv të subjektit politik jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë të punës nga dita e dorëzimit të raportit paraprak të auditimit. Raporti përfundimtar identifikon çdo gabim ose lëshim të raportit financiar, duke pasur parasysh çdo sqarim dhe inspektim duhet të dorëzohet sipas nenit 4.4 të kësaj rregulle.

Neni 5 Kontributet e fushatës

Subjekti politik nuk duhet ta pranojë asnjë kontribut që nuk do të ishte i pranueshëm të merret nga partia politike sipas Rregullës së KQZ-së 01/2008, mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike dhe në menyrën rregulluar me legjislacionin në fuqi.

Neni 6 Sanksionet

6.1 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke vepruar përmes zyrës mund ta ngarkojë subjektin politik, i cili e bënë Publikimin e Raportit Financiar të Fushatës, pas 45 ditëve kalendarike pas afatit përfundimtar, ashtu siç përcaktohet në nenin 3.1 të kësaj rregulle. KQZ-ja i transferon të gjitha gjobat dhe tarifat administrative në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

6.2 Ngarkimi i ndonjë gjobe ose sanksioni tjetër nga KQZ-ja nuk paragjykon ndonjë sanksion penal që mund të jetë i aplikueshem. Rastet të cilat mund të paraqesin një vepër penale do të dërgohet nga KQZ-ja në Zyren e prokurorit të Kosovës.

6.3 Subjekti politik mund të apeloj ndaj vendimit të KQZ-së për gjobë ose tarifë administrative në pajtueshmëri me Ligjin mbi Zgjedhjet e përgjithshme.

6.4 KQZ-ja mund ti shqiptoj tarifë administrative kundër subjektit politik për vonesë të dorëzimit të raporteve financiare të fushatës në pajtueshmëri me shtojcën 3 të kësaj rregulle.

6.5 Zyra mund të paraqesë ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) në pajtueshmëri me rregullat dhe procedurat e PZAP-it pas afatit për Publikimet e Raporteve Financiare të Fushatës përveq nëse,

- (a) subjekti politik brenda 15 ditëve pas afatit të paraparë në nenin 6.1 për dorëzimin e raporteve e publikimeve financiare të fushatës dorëzon raport të paplotë ose të pasaktë, ose dorëzon raport që nuk është në përputhje me nenin 3;
- (b) subjekti politik e tejkalon kufizimin e shpenzimeve të fushatës siç përcaktohet në këtë Regull;
- (c) subjekti politik nuk bashkëpunon plotësisht me Auditorët e Fushatës dhe nuk u siguron atyre qasje të plotë dhe të papenguar në shënimet financiare të subjektit politik siç përcaktohet në nenin 4, ose
- (d) subjekti politik ka pranuar kontribut në kundërshtim me dispozitën e përcaktuar në nenin 5.

6.6 Zyra mund të paraqesë ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) brenda dhjetë (15) ditësh nga afati përfundimtar për dorëzimin e raporteve të publikimit financiar të fushatës, pas afatit të paraparë në nenin 6.1.

6.7 Subjektet politike duhet t'i paguajnë gjokat e shqiptuara dhe tarifatat administrative, në xhirrologarinë e KQZ-së dhe të ja dorëzojnë Zyres kopjen e fletëpagesës.

Neni 7 Informimi publik

7.1 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke vepruar përmes Zyrës, krijon dhe ruan një dosje të Informimit Publik e cila përmban kopjet e fundit:

- a) regjistrin e donatorëve i cili tregon:
 - i. emrin e plotë dhe Regjistrimin Civil, numrin e pasaportës apo lejes së vozitjes për secilin person i cili ka kontribuar për subjektin politik, vlerën e kombinuar e cila i tejkalon njëqind (100) euro për çdo vit kalendarik;
 - ii. identitetin e subjektit politik cili e bënë pranimin;
 - iii. vlerën e kontributit; dhe
 - iv. datat në të cilat është dhënë kontributi;
- b) kopjet e të gjitha Raporteve të Publikimit Financiar të Fushatës, të dorëzuara në Zyrë;
- c) kopjet e të gjithë Formularëve të publikimit Financiar për Kandidatë për Kandidatët e certifikuar që janë dorëzuar në Zyrë; dhe
- d) kopjet e raporteve përfundimtare të kandidatëve të certifikuar lidhur me auditimin e bërë nga Zyra.

7.2 Zyra harton përbërjen e Dosjes së informimit Publik e cila do i vihet në dispozicion për shikim anëtarëve të publikut në një lokacion qendror i cili caktohet nga Zyra gjatë orarit të rregullt të punës, në faqen elektronike të KQZ-së si dhe në vende e kohë tjera siç mund të urdhërohen nga KQZ-ja

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull e ndryshuar zëvendëson Rregullën e mëparshme mbi Kufizimin e Shpenzimeve të Fushatës dhe Deklarimin Financiar dhe hyn në fuqi më 25.06.2009.

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Shtojca 3

Tarifat administrative mbi dorëzimin me vonesë të raporteve të publikimit financiar

		Kategoritë e subjekteve politike	
		<i>Partitë politike Iniciativat qytetare Koalicionet</i>	<i>Kandidatët e pavarur</i>
Dorëzimi me vonesë	1-5 ditë	250 €	25€
	6-10 ditë	300 €	50€
	10-15 ditë	500 €	100 €